Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e paguar

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

ИЗЛАЗИ ДВА ПУТА НЕДЕЉНО: ЧЕТВРТКОМ И НЕДЕЉОМ

DEL DY HERE NE JAVE: T'EJTEN DHE TE DIELLEN

Redakcija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 192 din
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Vjeti IV Nr. 148 | PRISHTINE, e ejte 30 Shtatuer 1948 | Çmimi 2 dinarë

Organet e blemjes dhe organizatat masovike duhet me u-aktivizue edhe ma teper per kontraktimin dhe blemjen e misrit

Na mbeten krejt pak dite para se me fillue blemjen e tepricave te detyrueshme te misrit. Simbas vendimit te Ministris qendrore te tregtis dhe furnizimit, me date 10 tetuer do te fillojë blemja e tepricave te misrit. Kjo asht date e fundit, deri kur munden prodhuesit me i kontraktue tepricat e veta te detyrueshme dhe te lira te misrit, e njikohesisht me i çdrytezue te gjitha te mirat e çvokret, perkatese deri ne kete date kane mbete fare pak dite kurse rezultati i deritashem i kontraktimit asht fare i vogel. Ne mbare Krahinen t'one jane kontraktue gjithsejt, deri me daten 29 te ketij muaji, 34,6% te tepricave te misrit.

Rezultatet e pakmaqeshme, te mbrrijtuna deri tash ne kete lami veprimi kane rrjedhe nga disa arsyena objektive, por ma teper nga agjitacjoni i dobet, nga te çmuemit e ngadalshem dhe jo real te prodhimit te misrit dhe nga ngadalesija ne pregaditjet per fillimin e blemjes. Te çmuemit e prodhimit te misrit asht krye ne mbare Krahinen t'one. Mirepo, ne disa rrethe, me gjithe udhezimet e dhanuna te çmuemit e misrit asht ba ireal. Per shembull rrethi i Prishtines dhe i Liplanit e kane prodhimin afersisht te njajte, mirepo ne rrethin e Prishtines asht çmue 9,5 cent metra miser per nji hektar, kurse n'ate te Liplanit 15,8 cent metra, ne rrethin e Dragashit 11 centi metra. Nga kjo shifet se ne rrethin e Prishtines nuk asht çmue drejte prodhimi. Ose per shembull rrethet Peje, Gjakove e Istok ku kualiteti i tokes asht gadi i njajte, te çmuemit e prodhimit levize per 6 centi metra.

Nji pengese objektive, per ngadalesimin e punes asht dhe ajo qe deri tash nuk kane mbrrijte planet perkatese te blemjes.

Tue marre parasyshe kohen e shkurte si dhe rezultatet jo te mira te deritashme te mbrrijtuna per kontraktimin e drithit dhe per kryemjen e pregaditjeve per fillimin e blemjes asht e nevojshme qe te perforcohet edhe ma puna agjituese, te vendoset evidenca ma e perpiket dhe te bahet lufte e ashper kondra ejmenteve te ndryshem spekulanta, te cilet perpiqen me pengue punen dhe me i ba bisht dorzimit te tepricave te drithit. Elementat anmiqe dhe spekulanta hapin parulla se gjoja nuk duhet me kontraktue deri sa t'u epen katundareve prodhuesa vendimet per dorezimin e sasinave te ndryshme te misrit. Disa prodhues i kane kapë parulla dhe besojne se do te zgjatet edhe ma afati i kontraktimit, siborse ka ndodhe me rastin e kontraktimit te drithnave te bardhe. Organet e blemjes si dhe organizatat masovike nuk kane ba perpjekje te mjaftueshme per t'iu spjegue prodhuesve randesin e kontraktimit te misrit, te mirat qe rrjedhin nga kontraktimi deri ne daten e caktueme dhe se afati per kontraktimin e misrit nuk do te shtybet, sepse nuk ka kurrfare arsyeje per kete pune, mbasi prodhuesit e dijne mire sistemin e kontraktimit. Prandaj kete pune duhet me ua njoftue te gjithe prodhuesve dhe me iu tregue se do te pesojne ata vete dame ne rase se nuk i kontraktojne tepricat e misrit, mbasi mbas dates 10 tetuer nuk do te munden fare me i marre bonat per artikuj industrijal dhe as per tepricat e lira nuk do te mujne me perfitue çmimin ma te nalte per 25%. Prandaj asht e nevojshme qe t'u bahen keto skjarime te gjithe prodhuesve dhe t'iu spjegohen kushtet e kontraktimit te misrit. N'anen tjeter duhet te kryhen sa ma pare te gjitha pregatitjet per fillimin e blemjes.

Ma e mira organizatë e Frontit populluer ne Krahinen t'one

Organizata e Frontit ne rrethin e Gjakoves asht nji nga ma te mirat jo vetem ne Krahinen t'one, por edhe ne Republiken Popullore te Serbis. Kjo organizate i ka vijue gara ne ndere te Kongresit te Peste te PKJ edhe mbas mbajtjes se Kongresit dhe ka mbrrijte rezultate te dukshme. Referatet dhe materjali tjeter nga Kongresi asht perpunue ne te gjitha organizatat e Frontit ne rrethin e Gjakoves ne punimet e ndryshme bujqesore kane dhane ma se 73 mije ore pune ne njerez e 438 ore pune me kafshe. Ne hapjen e kanaleve te reja per vadi je, çeljen e rrugicave dhe thanjen e moçalevet, frontistat kane dhane afer 29 mije ore vullnetare ne njerez dhe 100 ore pune me kafshe. Ne meremetimin dhe ngritjen e ndertesave per banese, organizatat e Frontit ne rrethin e Gjakoves kane dhane ma se 12 mije ore pune me njerez dhe afro 2.000 ore pune me kafshe. Ne meremetimin dhe ndertimin e rrugeve frontistat e rrethit te Gjakoves kane dhane afro 27 mije ore pune ne njerez dhe afro 8.000 ore pune me kafshe, kurse ne ndertimin e shtepijave kooperativiste gjate muejit gusht jane dhane ma se 62 mije ore pune ne njerez dhe afro 12.000 ore pune me kafshe. Edhe ne punen ne lamin kulturo-arsimore organizatat e Frontit ne rrethin e Gjakoves mbrrijne rezultate te mira. Neper grupet lexuese te Frontit, gjate muejit gusht kane marre pjese ma se 2.000 ndigjuesa, e pregatitjet per luftimin e analfabetizmit po bahen me sukses. Ne saje t'aktivitetit t'organizatave masovike ne kete rreth shperndahet nji sasi e madhe e shtypit central dhe atij krahinuer, gja kjo qe tregon kushjencen e nalte politike te turmave te gjana popullore ne kete rreth.

Gara ne ndere te Kongresit te pare te Sindikatave t'Unjisueme te Jugosllavis

Kolektivi i punes i sharrave „Kosmara" dhe „Zileb" nga Peja, i ka thue per gara ne ndere te Kongresit te pare te S.U.J. kolektivet punuese te sharrave ne Mitrovice dhe ne Rashke. Garat do te zhvillohen rreth plotesimit te planit te prodhimit, rreth uljes se çmimit te plote te kushtimit, rreth pakësimit te prishjeve dhe te ndaljeve te maqinave, disiplines ne pune, aftesimit te puntorve, ne punen kulturo-arsimore etj. Kolektivi punues i ketyne sharrave ka marre persiper qe deri ne diten e Kongresit te punoje me tri ndrime, t'a plotsojne planin e prodhimit 110%, t'a ulin çmimin e plote te kushtimit per 7,1% etj.

Sistemi i punes ne brigada asht tregue si shum i pershtatshem. Brigadat e Stanislav Sllavkoviqit dhe Mehmet Boqirit e kane plotsue detyren e tyne prodhuese me 180%, brigada e Veljo Simiqit me 170% e brigada e Ramadan Ahmetit me 160%.

Per aftesimin e puntorve te pakualifikuem, sipermarrja e ka shperblye njimodhet puntore me shume prej 6.700 dinare, e per kualitet te mire ne pune jane shperblye 22 puntore me shumen prej 18.200 dinare.

Ne ndere te Kongresit te pare te Sindikatave t'Unjisueme te Jugosllavis kolektivi punes i kesaj sipermarrjeje ka marre per siper me e shti ne perdorim sistemin e brigadave ne te gjitha vendet e punimit, mundej me u pakesue numrin e mungesave, me e permiresue disciplinen ne pune dhe me i perdore metodat e reja. Ne lamin kulturo-arsimore puntoret kane marre persiper me e perpunue materjalin e Kongresit te Peste te PKJ dhe me i mesue me shkrue e me kendue 130 analfabete.

—o—

Obligimet e kolektivit punues te sipermarrjes se ndertimeve „Graçanica"

Kolektivi i punes i sipermarrjes te ndertimeve „Graçanica" nga Prishtina, gjate muejit te kaluem ka mbrrijte rezultate te mira. Ne saje te organizimit te mire te punes dhe te perpjekjeve te punetoreve, detyra prodhuese e sipermarrjes asht tejkalue me 20%.

Brigadat e Frontit jane tue korrë sukses ne punen e tyne

Ma se dymije antare te Frontit populluer t'inkuadruem ne brigada te veçanta te punes, tue punue ne punet e ndryshme ne ndertimin e objekteve, ne premjen e pyjeve, ne hapjen e rrugeve, ne minjera etj., jane tue korre suksese te mdhaja. Keto sukseese qe korren dita me dite jane edhe nji shprehje e ndergjegjes se nalte patriotike e popullit t'one punues ne lufte per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one.

Neper shum vend-punime jo vetem qe plotsohen detyret e marruna persiper, por edhe tejkalohen. Shumica e brigadave e tejkalon normen me nji perqindje mjaft te madhe.

Numri i brigadave te Frontit asht shtue dhe keto jane caktue neper vend-punimet e ndryshme. Brigada e Pejes punon ne premjen e pyllit ne Rugove. Nji brigade e rrethit te Gjakoves e ka krye rrugen qe lidhte minjeren e Deves me Gjakove, tash asht tue punue ne ndertimin e rruges qe lidhe minjeren e Rabajt te Bokes me minjeren e Deves. Brigadat e Frontit te rrethit te Sohareks dhe te Dragashit jane tue punue ne ndertimin e hekurudhes Metohi—Prizren. Brigadat e rrethit te Podujeves, Rahovecit dhe Dragashit jane tue punue ne minjeren Trepça. Brigadat e rrethit te Prishtines dhe te Kamenices jane tue punue ne ndertimin e hekurudhes qe lidhe minjeren „Kosova" me stacjonin hekurudhuer Bellaçevc i Madh. Brigadat e rrethit te Gilanit dhe nji brigade e rrethit te Podujeves jane tue punue ne ndertimin e rruges pjore Rudare—Prolliom— (Kurshumli). Brigadat e rrethit te Liplanit jane tue punue prane sipermarrjes se ndertimeve „Graçanica" ne Prishtine. Jane ne formim e siper brigadat e Frontit populluer ne rrethin e Ferizajt, te Vuçiternes dhe te Serbices.

Brigadat e Frontit populluer do te korrin sukseese edhe ma te mdhaja ne qofte se e organizojne edhe ma mire sistemin e garave, evidencen dhe ne qofte se i shtijne ne perdorim flamuret kalimtar. Vetem brigada e Gjakoves, qe punon ne rrugen e Rabajt Bokes i ka zgjidhe mire te gjitha keto probleme.

Disa brigadave iu mungon udheheqsija e punes kulturo-arsimore, si per shembull brigades se rrethit te Pejes qe punon ne Rugove, brigadave te rrethit te Suhareks etj. Ne brigaden e dyte te Gjakoves zhvillohet me rregull puna kulturo-arsimore, gjithashtu dhe ne brigaden e Podujeves, e cila punon ne Prollom.

Ne brigaden e dyte te Gjakoves mbahen rregullisht konferenca ku bahen informime politike jane mbajte disa thema ne lidhje me referatet e Kongresit te Peste te PKJ-s, dhe punojne me rregull kurset analfabetike. Ne brigaden e Podujeves punojne 10 kurse analfabetike. Shembullin e ketyne dy brigadave duhet t'a ndjekin edhe brigadat e Pejes, Kamenices, Suhareks dhe te Prishtines.

—o—

Nji brigade te rijsh nga Gjakova dhe rrethi shkoi ne ndertimin e Beogradit te ri

Para disa ditesh, nji brigade e perbame prej 150 te rijsh, nga Gjakova dhe rrethi, shkoi ne ndertimin e Beogradit te ri.

Tash po bahen pregatitje qe te formohet per se shpejti edhe nji brigade plotesuese prej 100 te rijsh. Rinija e Gjakoves dhe e rrethit shpreh me kënaqesi gatishmenin e vet per te marre pjese ne te gjitha akcjonet e punes dhe keshtu te kontribuoje per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one.

H. B.

—o—

Formimi i kooperativave te reja katundare te punes

Katundarija e jone punuese po i shef per dite te mirat qe rrjedhin nga puna e perbashket prandaj po i pervehtesoe gjithnji ma teper kooperativat katundare te punes, si formen ma te pershtatshme per punen e perbashket, per nji jete ma te pasun e ma te kulturueme.

—o—

Ne katundin Isniq te rrethit te Pejes asht formue kooperativa katundare e punes prej 54 ekonomiash katundare te mesme dhe te vorfuna. Ne katundet Komoran, Bernjica e Poshtme, Uglare e Prece te rrethit te Prishtines, gjithashtu jane formue kooperativa te reja katundare te punes. Ne kooperativen e Komoranit jane regjistrue 48 ekonomi shtepijake, ne Bernjicen e Poshtme 46, n'Uglare 18 e ne Prece 43 ekonomi shtepijake. Regjistrimi i ekonomive shtepijake vazhdon ende. Edhe ne katundin Sushice te rrethit te Prishtines u formue kooperativa e re e punes ku muren pjese 55 ekonomi shtepijake me 290 hektare toke te punueme, 71 pende kafshe e 26 qerre hekuri. Te gjitha keto kooperativa te formueme i kane kushtet shum te mira te zhvillimit dhe te perparimit.

Keshilli i vendit Komoran fitoi flamurin kalimtar per sukseset e korruna ne ndertimin e shtepijave kooperative

Keshilli i rrethit te Frontit populluer dhe drejtorija e rrethit per ndertimin e shtepijave kooperative vendosen ne nji mbledhje te vetmen me ia dhane flamurin kalimtar keshillit te vendit te frontit dhe drejtoria perkatese ne Komoran per sukseset ma te mira te korruna ne ndertimin e shtepijave kooperative ne rrethin e Prishtines. Ne saje te punes s'organizueme ma se miri keshilli i vendit i Frontit populluer dhe drejtorija per ndertimin e shtepis kooperative kane mujte me krye te paret ne rrethin e vet shtepin kooperative. Perveç tjegullave t'tane materjali tjeter asht sigurue nga burimet lokal'e dhe anatari e Frontit kooperativistat me perpjekje dhe vullnet te forte kane mbrrijte me e zane vendin e pare ne kete akcjon te rendesishem per perparimin dhe ngritjen e vet ne nji shkall ma te nalte kulturale dhe per nji jete ma te mire.

Minjera „Kosova"

Ne saje te punes se brigades se Frontit, qe punon ne minjeren „Kosova", ndertimi i hekurudhes [illegible] ne [illegible] [illegible].

Rinija e rrethit te Podujeves n'akcjonet e punes

Ne saje te kushjences se nalte patriotike te rinis se rrethit te Llapit dhe te punes aktive t'organizatave te rinis, deri tash neper akcjonet e punes jashta rrethit jane dergue ma se 600 te rij e te reja. Organizatat e rinis ne rrethin e Llapit tash po e zhvillojne akcjonin per formimin edhe te nji brigade punuese te rinis prej 200—250 te rijsh, e cila do shkoje ne ndertimin e Beogradit te ri. [illegible] [illegible] ne kete brigade [illegible] nji [illegible] te rijsh.

PUNISHA PEROVIQ

Fronti popullUer mbas Kongresit te Peste te PKJ

(vijon nga numri 147)

Kur punet qendrojne keshtu, e ato qendrojne keshtu dhe kurrsesi ndryshe me te vertete jane te cuditshme, qeshatuke dhe vulgare dhe nuk mund te konsiderohen ndryshej vetem se shpifje per Partin t'one dhe per Frontin t'one popullore pohimet e neudhkroneve te Rezolucjonit te Byros Informative dhe e te gjithe atyne, te cilet keto pohime i kendojne ne gjendja melodina gritfese se Partija e jone shkaperderdhet ne Frontin popullner, qe vehten dhe programin e saje e identifikon me Frontin popullner, se Fronti popullner konsiderohet si fuqi kryesore udheheqese dhe se me ket gja braktisen doktrina marksiste-leniniste mbi partin revolucjonare te klases puntore.

Bile edhe nji organ i tille serioz theorik e politik, sikurse asht „Bolshevik" i Moskes i ka lejue vehtes qe t'i diskutoje trillimet e Rezolucjonit te Byros Informative. Ne numrin 14 (muejt korrik) te „Bolshevikut", n'artikullin e P. Fedosejevit „theorija marksiste e klasave dhe luftat e klasave", shkruhet:

„Udheheqsat e Jugosllavis e kane lane ne harrese kete te vertete kryesore te marksizmit, qe po rolin udheheqes te klases puntore nuk do t'mundte e mundon me e realizue bashkpunimin e puntoreve dhe katundareve ne luftte per transformimet demokratike ne vendet e demokracive popullore... Ne Jugosllavi, **filluen me e konsiderue si** rol udheheqes **te Vendit jo Partin** Komuniste, por Frontin popullner. Udheheqsat e Jugosllavis predikojne se Partija Komuniste nuk duhet me pase program te posaçem te vet, se ajo duhet me u-kriqe me programin e Frontit popullner.

Keto shkruhen mbas Kongresit te Peste te PKJ-s, i cili para popujve dhe para mbare botes ka qene afirmacjoni ma i madhi i rolit udheheqes te Partis s'one ne mbare jeten e Vendit, te cilin e prueni programi revolucjonar i Partis me kurs te kjarte per transformimin socjalist te Jugosllavis. Na akuzojne se kem theori te rrezikshme „Menshevike" e konsiderojme te drejte jo vetem per Vendin t'one, por edhe per te gjitha „vendet e demokracis popullore". Mund t'akuzohemi si menshevik Bernshtajna, Folmara, Buharina, dhe si ciaqjet ma te keqija ne historin e levizjes socjaliste, por kjo nuk do te pijne uje keto.

Per te gjitha keto akuza te turpshme theksohet si pohim nji citat i interpretuem shtrembet, prej tre rresh tane e ujyse nga fjalimi i shokut Tito ne Kongresin e Dyte te Frontit popullner. Ne realitet i tane referati i permendun i shokut Tito, kuptimi i tij dhe citatet e formulueme kjarte e thone te kunderten, i rrezojne akuzat e trillueme. Ne realitet ky referat domethane nji hope perpara ne theksimin e rolit udheheqes te PKJ-s, jo vetem ne Frontin Popullner, por edhe ne gjithe jeten shoqnore dhe politike te Vendit t'one. Mund te theksojshim me direta citatesh nga ky referat, ne te cilat shoku Tito flet kjarte mbi rolin udheheqes te Partis Komuniste ne Frontin popullner.

Por, nuk asht fjala vetem per citate. Praktika e perditshme e ndertimit te socjalizmit, praktika e perditshme e punes se te gjitha organizatave te popullit punues ka na, e edhe te Frontit popullner flet kjarte se udheheqesija i takon **ekskluzivisht** Partis Komuniste dhe vetem Partis Komuniste. Me te vertete shoku Tito ka qene ai qe ma teper se te gjithe e ka theksue nevojen e ndertimit te Partis si te pamvarun, fuqi politike t'organizueme, e cila vetem si e tille do te jete ne gjendje me udheheqe drejte dhe me drejtue punen e te gjitha organizatave te tjera masovike.

Athue mund te **flitet** mbi shkaperderdhjen e Partis ne Frontin popullner, kur mbi i antareve te se cilës i shtohet nji gjysem miljoni e persej kesaj edhe e antarave te cilet nuk jane te „regjistruem" ne Parti, por te pranuem simbas zgjedhjes individuale, ne baze te besimit dhe te gatshmenis se provueme se luftojne per programin revolucjonar te Partis? Athue mund te flitet per shkaperderdhjen e Partis, e cila e ka organizatat e ndertueme ne menyre te fuqishme prej krent deri ne fund, me udheheqsit dhe organet e Partis, te perhapun ne te gjitha pikat e prodhimit ne vend, ne te gjitha krahinat e, edhe ne katundet ma te largta. A thue mund pohohet kjo gja per Partin, njisit themelore te se cilës gjate nji jave mbajne regullisht nji, dy e edhe ma teper mbledhje, ne te cilat i diskutojne çashtjet e politikes aktuale te Partis, ne mes te tjerave, dhe punen per çashtjen e Frontit popullner?

Njerin vetem se mund t'admiroje vetmohimin e pashembullt, vetmohim deri n'abnegacjon, te kadrove t'ona te Partis, te cilat mujtne me i mposhte, dhe bile me sukses, veshtiresit kolosale me karakter organizativ dhe politik, te cilat na i imponoi perballja e komplikueme e ndertimit te socjalizmit. Por, kundrat t'ona te Partis i kane ne mendje fjalet e Stalinit mbi „transmisjonet" dhe „lituet" ata e djine se "... Partija lypset me e fitue patjeter e dita dites besimin e turmave proletare, duhet patjeter me politiken e vet dhe punen e vet me i sigurue vehtes perkrahjen e turmave, nuk duhet te komandoje, por, para se gjithash **duhet te binde**, tue u lehtesue turmave qe t'a njohin vijen e drejte te politikes se Partis ne baze t'eksperiences se vet, prandaj, ajo duhet patjeter te jete udheheqese, prijse dhe mesuese e klases se vet" (Stalin, "Çashtje te leninizmit").

Ne se Partija e jone shkaperderdhet ne frontin popullner dhe bahet Parti "kulakesh", mundet ma se miri me e vertetue ngjarja e kulakut tipik ideolog te ketyne „eksploatuesve ma shtazarak, ma t'eshper dhe ma t'egjer" (Lenin), Dragolub Jovanoviq dhe qoleve te tij (per shembull ne Mal te Zi Jefto Pavliqi), te cilet bash per kete çeshtje e jetuen thyemjen e tyne politike para turmave. Ata i trezoi roli udheheqes i Partis, ata e kane urrejte edhe vet egzistimin e organizatave t'ona te pamvarun te Partis dhe t'udheheqsis. Ata kane kerkue mundesi per krijimin e organizatave te pamvarun per vehte, t'udhuqerjtunit „bloku katundar" i pamvarun, tek e mbrojtja edhe ne rrethin formal te Frontit popullner.

Shoku E. Kardel per Dragolub Jovanoviqin, thote:

„Ai ka qene me fjale per tryelet e luftes Nacional-Çlirimtare, por kunder „metodave komuniste" ne realizimin e tyne, kunder t'ashtuquejtunes „diktature" te Partis Komuniste dhe kunder t'ashtuquejtunit „diktim te Moskes" ne Jugosllavi".

Kjo perpjekje e kundershtimit ndaj rolit udheheqes te Partis Komuniste dhe te pol'ikes se saje, pesoi deshtim, sikurse do te pesoje edhe çdo perpjekje tjeter e ngjajshme ne t'ardheshmen, pikrisht sepse egziston Partija Komuniste si fuqi e pamvarun, rolin udheheqes te se ciles, ne baze te besimit, e pranojne turmat e Frontit popullner si edhe disa antare t'ish partinave politike te dalluem dhe t'orijentuem kah demokracija.

Ne driten e fakteve te cituem, gjithashtu, asht gja e palogjim me pohue per mohetjen e njerezve te Partis, mbi gjysem ilegalitetin e saje te Partis, e cila te na asht Parti udheheqese, prise e njohun prej te gjithe popujve dhe te gjitha fuqive politike te Vendit.

Kur punet qendrojne keshtu, atehere duhet te parashtrohet pyetja: kujt dhe cilit i sherbejne akuzat e padokumentueme dhe te pasakta te drejtueme n'adresen e Partis s'one? Kjo asht pyetje te cilen me arsyetim e parashtrojne turmat t'ona popullore dhe ne te cilen jane te detyruem me u-pergjegje autoret e akuzave te fsheme. Ne çdo rast na e kemi kjarte se ato i sjellin dam mbare Frontit socjalist demokratik ne bote.

*

Nuk mund te thuhet se lusbate e Byros Informative e kunder Vendit t'one dhe Partis s'one nuk ka pase nji fare efekti negativ ne pikepamje te punes s'organizatave te Frontit Popullner. Ajo ka shkaktue pshtjellim te disa shoke te na e, edhe ne boten e jashtme ne pikpamje te karakterit dhe te rolit te Frontit popullner, ne pikpamje te fatit te tij te mavujeshem. Gjithashtu, pregatitjet per Kongresin e Peste te PKJ-s — gja ne te cilen asht shperfaqe mjaft kohe per thyemjen e fjalimave te padhemeltu dhe te rrejshme te Partinave - antare te Byros Informative - ia larguen vemendjen per nji moment nga puna e organizatave te Frontit, keshtu qe, ne qoftese do te vazhdohej keshtu, mund te kishte perfundime te damshme.

Shoku Tito qysh ne Kongresin e Dyte te Frontit popullner e tregoi mendimin e gabueshem se frontet popullore jane diçka „te vjetrueme", diçka qe sot „nuk i pergjigjen" nevojave te zhvillimit, shoku Tito atehere tha:

„... po shihet se, Fronti popullner ke na nuk e ka luejte vetem rolin e madh te luftes, porse sot ka rol edhe ma te madh ne ndertimin paqesuer te Vendit. Prandaj, ai asht nji nevoje e domosdoshme per popujt e Vendit t'one ne t'ardheshme... Fronti Popullner po bahet **organizate politike e qendrueshme, e te gjithe popujve...**"

Tue u-nise prej ketij fakti, Kongresi i Peste i Partis s'one, tue e prue Programin e Partis i dha Frontit popullner vend te posaçem ne kete program. Me ket dhe me programin e Partis asht fiksue rol i madh i Frontit popullore si i organizates masovike i te gjithe popujve ne transformimin socjalist te Vendit t'one.

Pikrisht n'etapen e tashme te zhvillimit t'one, kur asht shenue kursi i kjarte per rekonstruimin socjalist te Vendit, i cili e gjene shprehjen e vet materjale ne realizimin e Planit pesvjeçar, sot, ma teper se kurr na asht i nevojshem bashkimi i forte i klases puntore, i katundaris punuese dhe i shtresave te tjera prodhuese. Kur ky bashkim e gjene formen e vet organizative ne Frontin popullner, atehere asht e kuptueshme perpjekja e Partis per nji fryte te tille te qmuashem te revolucjonit t'one t'a perforcoje, t'a zgjanoje dhe t'a gdhendose edhe ma teper.

Natyrisht, e gjithe kjo nuk e zvogelon randesin e Partis, rolit e saja, por perkundrazi - puna e drejte e Partis, udheheqja e saje me sukses ne te gjitha organizatat masovike te popullit punues e perforcon autoritetin e saje; e gjithe kjo nuk e perjashton, por e bon te nenkuptohet perforcimin organizativ dhe politik te vet Partis, forcimin dhe zhvillimin e saje te gjithanshem.

Ne te vertete, puna aktive dhe udheheqja e turmave perfaqeson nji prej faktoreve ma kryesore te zhvillimit te Partis. Jo-aktiviteti i organizatave te Partis, ndamja e tyne prej turmave, shmangja nga kritika e ketyne turmave, metodat byrokratike t'udheheqjes, vetkenaqesija me sukseset — te gjitha keto jane dukje, te cilat e terheqin mbrapa Partin, e çojne kah dobesimi i saje. Puna aktive ne Frontin popullner e shpeton Partin prej ketyne dobesinave. Ne programin e PKJ-s, thuhet: „Fronti Popullner i Jugosllavis asht nji organizate e tille masovike, ne te cilen Partija Komuniste e Jugosllavis, qe te mundet me e plotsue me sukses rolin e vet, — meson prej turmave punuese, e ndigjon zanin e tyne me rastin e caktimit te politikes se vet dhe te detyreve konkrete, dhe, ne te cilen Partija Komuniste per ket arsye e ka instrumentin ma masovik te kontrollit per drejtesin e politikes se vet". Tue punue ne Frontin popullner, tue u-lidhe ma se ngushti me turmen e gjane t'antave te Frontit ne punen konkrete, organizatave te Partis u epet mundesija qe ne menyre organizative t'a vertetojne drejtesin e politikes se vet nepermjet t'organizatave te Frontit. Aktivistat e Partis ne kontaktin direkt me turmat ne mbledhjet e Frontit, n'akcjonet e punes, ne manifestimet politike dhe kulturale do te munden me i ndigjue ma se miri deshirat dhe nevojat e tyne, me marre ne provim kritiken e tyne dhe propozimet e tyne, gja qe do te jete garancija ma e sigurte e punes se drejte t'organizatave te Partis.

Me kete rast asht e nevojshme me theksue se Frontin dhe organizatat e Frontit nuk duhet me i marre formalisht, te mos trajtohen as organizatat e Frontit as disa antare te Frontit si nji fare bishti i Partis, diçka qe asht e detyrueme vetem me i ndigjue Partin. N'organizatat e Frontit dhe tek antaret e Frontit duhet me e zhvillue inisjativen, me e zhvillue ne menyre te gjithanshme aktivitetin e tyne, me u dhane hov dhe vrull, me u-sjelle ndaj tyne si ndaj organizates se vet ma t'afert, e cila duhet me punue dhe me u-zhvillue, ne te cilen komunistat i realizojne ma se miri lidhjet me turmat, mesojne prej turmave dhe ne baze t'eksperiences masovike dhe te kritikes masovike i permiresojne gabimet e veta.

Detyrat qe sot parashtrohen para Partis, e me kete edhe para Frontit popullner, çfaqen shkurtimisht ne luften per realizimin e Planit pesvjeçar. Kjo asht detyre, e cila simbas gjanesis dhe veshtiresive te veta kerkon perpjekjen e te gjitha turmave popullore te barabarte me ate nga lufta Nacjonal—Çlirimtare, ne mos edhe ma teper. Eksperijenca e deritashme tregon se popujt t'one jane t'afte dhe te gatshem me u-kacafite me keto veshtiresi. Heroi krijues dhe heroizmi punues, te denje ndaj heroizmit te kohes se luftes ne fagtojne cilesit e mrekullueshme te turmave t'ona punuese, te cilat Partija e jone ka dijte me i zhvillue dhe gjallnue nepermjet Frontit popullner dhe t'organizatave tjera dhe te cilat jane garanci se do t'a realizojne me siguri planin t'one te ndertimit socjalist dhe te transformimit socjalist te Vendit. Turmat t'ona punuese, te bashkueme ne Frontin popullner, dhane shembuj te panumert t'inisjatives krijuese, e cila po transmetohet me tutje, prej fabrikes ne fabrike, prej nji brigades punuese ne tjetren, tue formue ne kete menyre levin punues te pashoq, i cili po ngrihet deri ke kulti i punes per lumnin dhe perparimin e atdheut te vet socjalist.

Udheheqsat t'one te Partis kane theksue gjithmone se ndertimi i socjalizmit, i cili domethane shpronesim i klaseve eksploatuese, e forcon pa tjeter rezistencen e ketyne klaseve. Klasat eksploatuese nuk jane dorzue kurr pa lufte, mbasi i kane lane vullnetarisht pozitat e veta. Procesi i zhvillimit te revolucjonit t'one, gjithashtu e ilustron kete. Karakteristika e kesaj rezistence te na qendron ne faktin se fuqit reakcjonare, te rrezuene nga pushteti, fuqit' ekonomike te mimueme dhe pa mbeshtetje ne turmat kalojne ne metodat e mshefta luftarake, tue u-perdore prej dhelpnis, sabotimit, diversionit, spijunazhit etj.

Te gjitha keto nuk mund te çfaqen ne punen e organizatave popullore, sikurse asht Fronti Popullner e edhe vet Partija. Akcjoni i armikut te klases ka per qellim dobesimin e ketyne organizatave, minimin e influences se tyne dhe thyemjen e tyne. Me kete rast ai perdoret prej demagogjis dhe fshehtesis te shumllojshme, tue mos lane pa perdore as krimet direkte. Kjo qendrese e klasave te shpronesuame terhjekje me vehte ne menyre te pakundershtueshme lekundjet e disa shtresave te popullit, sidomos ne katund, qe asht gja e pervoueshme dhe e natyrshme ne periudhen e kalimit prej kapitalizmit ne socjalizem.

Te gjitha keto duhet me i pase ndermend antaret e Partis dhe te Frontit, te cilet jane te detyruem me i zbulue me kohe armiqet ne radhet e veta, me i demaskue dhe me e zhdukë punen e tyne te damshme. Keshtu edhe Fronti popullner do te spastrohet prej elementave te damshem dhe reakcionare. Nga ana tjeter, ai do te zgjanohet dhe do te perforcohet me hymjen e njerzve te ri punues dhe patriotve te dhanun per ndertimin socjalist, e qe ende jane te paorganizuem.

Kongresi i Peste i PKJ-s ne „Rezolucjonin mbi detyrat themelore t'ardheshme t'organizatave te Partis Komuniste" keshtu i ka formulue detyrat kryesore, te cilat parashtrohen ne lidhje me Frontin popullore:

„a) Punen politike me turmat, spjegimin e detyreve dhe te rrugeve te ndertimit t'one socjalist dhe te detyreve te luftes kunder aktivitetit te reakcjonit. Spjegimin e masave konkrete te pushtetit popullore ne ndertimin e socjalizmit, thyemjen e manovrave t'armikut, demaskimin e elementave reakcjonare, te cilet jane fshe n'organizatat e Frontit, spjegimin e politikes nderkombetare dhe demaskimin e manovrave te reakcjonit imperjalist dhe te nxitsave te luftes, luften aktive politike kundra akcjoneve t'armikut te socjalizmit, kunder lahatjes ne disa shtresave te popullit punues, zhvillimin e gjane ne baze vullnetare per studimin e marksizem-leninizmit, studimin e luftes s'one Nacjonal—Çlirimtare e te problemeve te ndertimit t'one dhe te problemeve te politikes nderkombetare;

b) aktivizimin direkt te turmave per ndertimin socjalist, zhvillimin e akcjoneve masovike te punes, ndihme kooperativizmit dhe lufte per realizimin e planeve fuqiqesore;

c) pjesmarrja e gjithanshme e turmave ne punen e organeve te pushtetit popullore, zhvillimi i kritikes dhe i kontrollit te turmave punuese mbi punen e organeve shteterore dhe mbi aparatin ekonomik."

Zbatimi i ketyne detyreve, te cilat i ka parashtrue para nesh Kongresi i Peste, ne t'udhe te pare mvaret prej organizatave t'ona te Partis, prej komunistave. Nuk duhet as me dyshue se aktivistat t'one te Partis do t'i realizojne me sukses te gjitha keto detyre dhe me kete gja te tregojne edhe nji here se me te drejte e plotsojne rolin e lavdishem t'avangardes se te gjithe njerzve punues. Ma ne fund duhet me theksue edhe nji here se asht i damshem dhe i rrezikshem çdo nençmim i rolit te Frontit popullner, se kjo çon kah t'ndamit i Partis prej turmave, e me ket gja dhe kah dobesimi i ritmit te zhvillimit t'one socjalist.

Ne Gjakov u-ba zgjedhja e delegateve per ne Kongresin e I-re te S. U. J.

Para disa ditve u-mbajte ne Gjakove konferenca e sindikatave te rrethit te Gjakoves dhe te Rahovecit per zgjedhjen e delegateve per konferencen Krahinore dhe per ate te Kongresit te I-re te S.U.J.

Konferencen e hapi shoku Isa Vokshi dhe mbandej ia dha fjalen shokut Tahir Hoxhes, prokuror'i popullit per rrethin e Gjakoves, i cili foli mbi rrolin e madh te PKJ per organizimin e sindikatave ne Jugosllavi. Nder te tjera, tue ceke edhe akuzat qe i bahen K.Q.P.K.J. dhe Vendit t'one nga ana e vendeve demokratike popullore, shoku Hoxha tha: „Te gjitha fitoret t'ona ne fushat e ndryshme i kemi mberrijte sepse kemi pase udheheqjen e ketij K.Q. me shokun Tito ne krye e kjo d.m.th. se s'na ndane gja as nga K.Q. as nga shoku Tito. Ato jane mishnimi i jone, jeta e jone, e ardhshmja e jone". Mbas shokut Hoxhes e muer fjalen shoku Apostol Tanefi, profesor i shkolles normale te Gjakoves, i cili dha nji kumtat te kjarte mbi jeten e zhvillimin e sindikatave ne Jugosllavi prej vitit 1918 e kendej.

Ne fund u-bane zgjedhjet e delegateve ne te cilat u-zgjodhen: shoku Isa Vokshi per Kongresin e Pare te S.U.J. dhe shoket: Pashko Trendaj, Isa Vokshi, Sima Petroviq, Haki Puka dhe Xhem Gllava per ne Konferencen Krahinore.

T. H.

Arsim e kulturë

Detyret e Bashkimeve te shoqnive kulturo-arsimore

[illegible] kryesore qe shtrohet para te gjitha shoqnive kulturo-arsimore te [illegible] dhe qyteteve jane per[illegible] [illegible] e [illegible]. I [illegible] te [illegible] mbi 1 [illegible] e [illegible] mbi 30 [illegible] te [illegible] e Bashki[mit] te shoqnive kulturo-arsimore te Vendit asht [illegible] i krijimit te bibliotekave, ngritja e kuadrave te kualifikueme per biblioteka dhe zhvillimi i bibliotekave ne vendin t'one pergjithesisht.

[illegible] te garave, te gjitha bashkimet e shoqnive kulturo-arsimore te rretheve dhe qyteteve, duhet te bajne planin e garave, te bajne [illegible], e [illegible] te [illegible] edhe pergjegjesit e [illegible]. Per me [illegible] me sukses punen e ketyne detyreve, bashkimet i shoqnive kulturo-arsimore rrethit, duhet te mbaje seksione te perditeshme, se [illegible] punet [illegible], [illegible] etj.

Caktimi i kalendarit asht çashtja e pare qe shtrohet para bashkimit. Ky kalendar duhet te percaktoje detyret e bashkimit te tij per gjasht muej. Ne baze te kalendarit te pergjithshem bashkimet e shoqnive te rretheve e qyteteve duhet te bajne planin e punes me afate te caktueme.

Sidi dhe puna e bashkimeve te shoqnive kulturo-arsimore te rretheve e qyteteve jane nji nga detyret kryesore ne punen e tyne. Shum kryesina te ketyne shoqnive edhe deri sot nuk i kane formue seksionet e tyne te duhuna, si jane kjo seksjonin e kultures se pergjithshme, seksjonin teatral, te muzikes, folklorit e seksjone tjera. Keto duhet formue sa ma pare. Mandej Bashkimi i shoqnive kulturo-arsimore, punen e zhvillimit profesjonal te secilit seksion duhet t'a shtroje si detyren e vet kryesore. Forcimi i lidhjes se ngushte ndermjet shoqnive te rretheve dhe bashkimit te shoqnive kulturo-arsimore asht i domosdoshem.

Katundarja Marija Hudelin - luftare kundra analfabetizmit

— Ndet emna te luftareve te dalluem ne luften kundra analfabetizmit te [illegible], para pak kohe jane çmue prej Qeverisë se RP te Kroacis asht edhe emni i Marije Hudelin, katundares prej Zornices ne Baranja, rrethi Beli -Manastir. Kjo katundare asht çmue me 10 mije dinare per luften e mbaset qe ka ba kundra analfabetizmit.

Mbasi ne Zornice nuk kishte ndertese shkolle, e per me shkue ne shkolle qe gjindej ne katundin e afert, duhej me bare ne kambe nji ore te [illegible] atehere, per me shpetue te bijen prej t'ecunit e perditshem dhe mbasi ia kishte ble librat e fletoret e duhuna, vendosi t'a mesonte vete dhe keshtu kalonte me kohe programin e parapam. Keshtu e bija mbasi i perveteson mesimet e klases se pare, para komisjonit iu nenshtrue provimit te kesaj klase, tue u-dalë me perfundim te shkelqyeshem. Keshtu e kreu edhe klasen e dyte.

Nji dite Marija Hudelin i thirret te gjitha grate e mashkujt analfabete te vendit te vete dhe iu shtroi propozimin qe te hapin nji kurs analfabetik. Te gjithe njerzit e pranuen propozimin e saje. Mbas pak kohe kursi u-hap me pese femna dhe kater mashkuj. Asnjeni prej tyne nuk e kishte nji ore pa e ndjeke. Marija Hudelin tregoi vullnet te forte e deshire te flakte ne punen e ketij kursi. E shtyeme prej perfundimit te mire, ajo vendosi me hape nji kurs tjeter ne Peskov, ne rrethin e pasunis shtetnore te Osjekut. Por, mbasi ky vend ishte i larg 7 kilometra prej vendit te saje, i propozuen me hjeke dore prej kesaj pune.

— Nuk mundesh ti me e krye kete pune, lodhesh, grue je ti, çka mund te bajsh ti e mjera — i thojshin te gjithe.

Por Marija as qe iu vente veshin ketyne fjaleve. Ajo shkon te drejtori i pasunis se shtetit, i mbledhe njerzit dhe ju kallxon se ajo mendon me hape nji kurs analfabetik.

Keshtu pra Marija, tane dimnin punoi me dy kurse. Dy here ne jave i vizitonte puntoret analfabeta ne pasunin e shtetit te Peskovit. Keshilli popullor i vendit i ka ndihmue Marijes mbi i ble librat e materjalin e duhun per kurse. Ne fund, te gjithe njerzit analfabeta ne Zornice ja mesuen me mesue shkrim e kendim, ne Peskov mesuen gjithashtu shkrim e kendim 18 puntore.

Prandaj kur u mnerr vesh se Marija Hudelin ishte çmue prej Qeveris se RP te Kroacis me 10 mijë dinare, te gjithe njerzit e Zornices dhe punoret e Peskovit qene te kenaqun. Marijes Hudelin, luftares me plot te drejte ne luftaten kundra analfabetizmit, te gjithe katundaret e Zornices ja shtrenguen doren.

Proklamim i sulmuesve ne kombinatin e druve ne Mitrovice

Mitrovice:

Ne kombinatin e druve ne Mitrovice u-ba me 26 te ketij muaji proklamimi i sulmuesve. Ne seksjonin e adruktitetaris u proklamuen 12 sulmuesa ne mes te te cilve dallohen sidomos per perpjekjet e tyne Elezoviq Nikolla Malokoviq Velibor, Elek Jovanka e Cebecek Viktor. Ne puntorin e pjlakave sliper jane proklamue dy sulmuesa. Ne puntorin e adruktitetaris jane Tadenferac 9 e ne puntorin e pllakave sliper 5 puntore. Po ashtu jane falenderue udhebeqat teknik Vukojeviq Krsto, Nhankoviq Savo, si dhe nepunsat e zyrave te sipermarrjes Buzdimitroviq Petar e Vukoviq Jovan. Mbas proklamimit solemn te sulmuesve, u-dha nji çfaqje per sulmuesat e sipermarrjes ne fjale.

—o—

Ne rrethin e Podujeves jane tue u-mbrrijte perfundime te mira per nderzimin artificjal te dhenve

Ne rrethin e Podujeves asht tue u-zhvillue me sukses aksijoni per nderzimin artificjal te dhenve. Neper keshillat ma perparimtare te vendit Krpimej dhe Orllan jane organizue vendet e posaçme, ku blegtoret e katundeve fqij i sjellin delet per nderzim. Asht parapa qe ne kete rreth te nderzehen artificjalisht 1,500 dele. Populli e ka pranue me deshire ket akcjon dhe parashifet qe Plani i parapame jo vetem te realizohet, por edhe te tejkalohet.

—o—

Ne rrethin e Pejes po nderzehen artificjalisht delet e stacjonit te selekcjonimit dhe te pasunis se shtetit

PEJE:

Edhe ne rrethin e Pejes asht tue u zhvillue me sukses akcjoni i nderzimit artificjal te dhenve bardhoke. Me nderzimin artificjal te kesaj race te delve do te mbrrihet qe keto t'a permirsojne leshin ne cilsi dhe ne tansi. Ne stacjonin blegtoral te seleksjonimit do te nderzehen artificjalisht te gjitha delet e gjithashtu edhe ato te pasunis se shtetit ne Vitomirice.

Fiskultura dhe Sporti

U-filluen ndeshjet e foot-ballit ndermjet shoqnive te kualifikueme per kampionatin e zones se peste

Te djelen fillluen ndeshjet e foot-ballit ndermjet shoqnive te kualifikueme per kampionatin e Zones se peste. Te gjithe fiskulturniket dhe simpatizeret e sportit me pa durim e pritën ne mbare Krahinen t'one zhvillimin e ketij manifestimi sportiv. Ne te gjitha fushat sportive turma te medha publiku kane asistue ne ndeshjet e para te kampionatit. Ne te gjitha vendet jane krijue te gjitha kushtet e nevojshme dhe jane marre masat e duhuna qe ndeshjet t'arrijne qellimin e deshiruem dhe te lane pershtypje te mira nder spektatoret t'one, me teknike ma te persosun, gjallni e sistem loje, me lojtari e sjellje korekte ashtu si u ka hije shoqnive e sportistave te vertete.

—o—

Rezultatet e turneut te I-re

Ardhemenija Luftetari 1:1

Te djelen, ne fushen sportive te Pejes u zhvillue ndeshja e pare e Kampionatit. Te dy skuadrat jane tregue t'afta per me perballue edhe lojna te veshtira. Me gjithse teknika e sistemi i lojes ka mongue, por gjalleija e shpejtesija, rezistenca e disiplina ka qene te dukshme. Loja perfundoi me rezultatin asnjanes.

—o—

Polet - Metohija 4:0

Kjo ndeshje ne vend qe te zhvillohet per kampionatin, morri ngjyren e nji ne mlysore. Nji ngjarrje e ketille nuk i pergjigjet disiplines sportive dhe as rregulloreve te sportit e çka ma teper humb edhe serjozitetin. Prandaj Bashkimi fiskultural i krahines s'one duhet me kohe me i marre te gjitha masat e duhuna dhe me i caktue arbitrat e delegatet te cilet me siguri do t'i pergjigjen detyres se ngarkueme. Keshtu arbitri Eugen Eller nga Mitrovica, me gjithse i njoftuem me leter rekomande qysh t'ejten jo vetem qe nuk ka shkue me arbitrue por as qe ka njoftue komisjonin e arbitrave per me dergue ndonji tjeter ne vend te tij. Kjo ndeshje do te persëritet ma vone.

—o—

Sanxhak-Vllaznija 2:2

Skuadrat kane qene t'ekuilibrueme. Lojtaret e Sanxhakut ne terenin e tyne jane tregue teknikisht ma te mire nderse Vllaznija asht shque me lojen e gjalle e te shpejte qe kane dhane. Rezultati asnjanes i pergjigjet lojes.

—o—

Trepça-Hylli kuq 6:0

Ne fushen sportive te Mitrovices u-zhvillue ndeshja ndermjet skuadrave te siperme. Loja ka qene e ngadalshme dhe e ftofte ne pergjithsi. Perfundimi 6:0 ne favor te Trepçes nuk i pergjigjet lojes.

—o—

Me 3 te k. m. do te ndeshen keto shoqnina:

Ne Gjakove: Vllaznija — Trepça
arbitron Kol Lekaj

Ne Gilan: Hylli Kuq — Metohija
arbitron Ilija Paternogiq

Ne Prishtine: Polet — Ardhmenija
arbitron Josip Volenik

Ne Ferizaj: Luftetari — Sanxhak
arbitron Gjoko Stojkoviq

—o—

Prishtine:

Me 6, 7, 8 te Tetorit do te mbahet nji seminar per aftesimin e pregatitjen e kuadrave t'arbitrave, prandaj lajmerohen te gjith ata qe dishrojne te kualifikohen si arbitra duhet te paraqiten ne daten e siperme dhe te pregatisin rregulloren e topkambes veçanerisht pjesen shkoqitse te çdo kapitulli.

Riorganizimi i kooperativave bujqesore

Podujeve

Ne te gjitha kooperativat bujqesore te rrethit te Podujeves po mbahen mbledhje te jashtzakonshme, ne te cilat po bahet riorganizimi i kooperative bujqesore ne baza te reja. Deri tash jane mbajte mbledhjet e jashtzakonshme ne shtate kooperativa vendi. Nepermjet te ketyne mbledhjeve te jashtzakonshme po zgjidhen edhe keshilla te ndryshem per bujqesi, blegtori e pemishte, per elektrifikim, per punen e perbashket te tokes etj. Prane te gjitha kooperativave jane formue keshilla per tregtin, per kredinat dhe kursimin, ekonomin lokale dhe punen kulturo-arsimore. Per punimin e perbashket te tokes jane regjistrue 137 ekonomi shtepijake.

Asht e nevojshme qe ne kete rreth te perforcohet edhe ma puna propagandistike ne lidhje me spjegimin e nevojave dhe te dobis se riorganizimit te kooperativave ne baza te reja. Sidomos duhet me i popullarizue keshillat per punimin e perbashket te tokes, dhe te mirat qe rrjedhin nga kjo pune.

—o—

Mitrovice:

Me qellim qe turmat e gjana katundare te njifen sa ma mire me organizimin e ri te kooperativave bujqsore, keshilli i rrethit te Frontit popullor ka organizue thema te ndryshme neper te gjitha katundet e rrethit te Mitrovices. Per mbajtjen e ketyne themave asht pregadite ekipa e posaçme e aktivit t'agitatorve. Kujdes i veçant i kushtohet spjegimit te randesis dhe rolit te keshillave dhe seksjoneve te ndryshme ne per kooperativa e sidomos keshillave per punimin e perbashket te tokes.

—o—

Mitrovice

Ne katundin Radiq Pole asht perfundue shtepija kooperative. Kjo asht shtepija ma e madhe ne rreth. Me rastin e inaugurimit te kesaj shtepije vendasit i kane ftue perfaqsuesit e te gjitha organizatave masovike nga keshillat tjera te rrethit te Mitrovices.

Nga Bashkimi Sovjetik

Rezultat'i mire ne pune i kater vajzave sovjetike

Ne garat e mdha te prodhimit per kryemjen e para-kohe te Planit pesvjeçar, nji vend me ndere zen rinija Sovjetike. Ajo dite per dite po shenon heroizem te ri pune. Ne kete artikull po e pershkruejme punen qe ka ba nji prej brigadave te rinis.

Tatjana Djaçkova, vajze 22 vjeçare, u-da ne za ne mbare Bashkimin Sovjetik, sa qe, mbi te shkruejne fletoret, flitet nder konferenca e [illegible].

Tatjana Djaçkova asht puntore ne fabriken e automobilave „Stalin" ne Moske. Qysh nji vjet e kendej me brigaden e vet ajo e thei normen e [illegible] perfundimit te brigades se saje te punes. Djaçkova ua pergjigjet se rezultatet e mira te brigades se saje te punes, jane sigurue se saje t'organizimit te rregullt te punes, racjonalizmit te prodhimit, ngritjes se rithmit te punes dhe sigurimit te plote me vegla per pune. Kurdi duhet shtue edhe fuqija e anetareve, qe te ndihmohet me shpejt dhe e garave socjaliste. Mbasi e ka lexue artikullin e Komsomoles, stahanovistja Ana Kucnjicov, ne fabriken e automobilave, Djaçkova vendosi me ndjeke shembullin e saje. N'artikullin e vet Kucnjicova shkruente se antaret e Komsomolit duhet t'i ndihmojne shtetit ne punen e tejkalimit te Planit pesvjeçar. Tatjana Djaçkova e analizoi punen e shoqes se vet dhe i pau te gjitha mundesit e pashfrytzueme. Ne radje, derisa po i bjente maqinat e shokve, humbte kohe te çmueshme, pse atehere kurkush nuk po punonte. Keshtu kane punue ne kohen e perparshme. Tashti ajo i pregadite qysh ne mbramje te gjitha maqinat, e neser posa te vije shoqet me njihere ia hyjne punes.

Masat racjonalizuese kane dhane mundesi brigades se Djaçkovit me e ngrite normen e dites per afer 20%. Qysh nga mbarimi i muejit te gushtit te vjetit te kaluem brigada po punonte pjesenisht simbas normave te vjetit 1948. Djaçkova me shoqe e muerr vesh se do te mundej me mbrri stakanovisten Ana Kucnjicova. Duhet me i çfrytzue te gjitha mundesit. Brigada po ngjirrte pjese maqinash. Per kete pune duhej me krye veprime te veçanta. Por, brigada vendosi qe keto pjese maqinash te bahen, tue e caktue per kete pune nga nji puntore per çdo ndrrim, keshtu qe nji puntore te punonte ketu vazhdimisht. Ne kete menyre u-kursye mjaft kohe. Organizata e komsomolve ne fabrike e uroi brigaden per punen e saje dhe vendosi me perdore metodat e punes se saje ne te gjitha seksjonet e brigadave te rinis. Te neserme brigada e Tanjana Djaçkova muer persiper me krye para afatit normat e 1950. Brigada filloi me e shpejtesue punen e maqinave te veta. Ne kete pune i ka ndihmue udhebeqsi i seksjonit.

Mbas pak kohe, drejtori i fabrikes urdhnoi qe te gjithe udhebeqat t'a studjojne me kujdes pervojen e brigades se Djaçkoves dhe t'a zbatojne ne te gjithe fabriken.

Ma ne fund erdhi dita kur brigada ia hyni me punue me normat e 1950. Ne fabrike gjindet diagrami i cili shenon shtimin e prodhimit te brigades se Djaçkoves. An'embanet autobusit bleret jane te shkrueme tri kolona shifrash: 100, 278, 1000. Shifra e pare tregon perqindjen e normes se muejve per vjetin 1947, shifra e dyte — normen e projektueme per vjetin 1950 dhe e treta — normen e vertete te mbrrijtune ne vjetin 1948.

Sot brigada e Djaçkoves ka shum perkrahsa ne fabrike. Normat e projektueme per vjetin 1950 po i kryejne me maqina te rijt e te rejat. Edhe vete Djaçkova po e perfeksjonon punen e vet. — Na komsomolet dhe komsomolet mbajme pergjegjesi te veçante per punen t'one para Partis, komsomolit para popullit sovjetik — thote Tatjana Djaçkova.

Keto fjale jane deshmi e vetedijes se nalte, me ane te se cilës, ajo si dhe e tane rinija sovjetike e jep tane ndihmen e vet per kryemjen e Planit pesvjeçar.

Nga situata nderkombtare

Fjalimi i Vishinskit n'Asamblen e pergjithshme t'OKB

Paris:

Ne seksjonin plenar te seances se Kuvendit te pergjithshem t'Organizates se Kombeve te Bashkueme foli shefi i delegacjonit sovjetik Andrej Vishinski.

Tue fole per qeshtjen e t'ashtuquejtunit komisjon ballkanik, Vishinski ka thane: „ne seancen e fundit te Kuvendit te pergjithshem kundra çdo ligji asht krijue komisjoni Ballkanik. Ky asht krijue me qellim qe te lehtesoje shtypjen e luftes se popullit grek per lirin n Greqis — nga njena ane dhe perveç kesaj te ndihmojne padinat e rrejshme te monarko-fashistave grek kundra fqijve verior te Greqis. Nji komisjon i tille, e me detyra te tilla, nuk ka mujte me zgjedhe dallina as per velde as per Organizaten e Kombeve te Bashkueme. Qysh ne vjetin e kalueme ne komitetin numer 1 te Kuvendit te pergjithshem jane paraqite nji seri faktesh mbi punen jo objektive te ketij komisjoni. Asht pa se asnji perfundim i pershtatshem dhe i drejte nuk mund te nxjerret ne baze te materjalit te ketij komisjoni.

Sot shofim se situata nuk ka ndryshue, por per kete qeshtje kemi per te bisedue ne diskusjonin mbi t'ashtuquejtunin problemi i Greqis".

Tue kalue n'aktivitetin e Organizates se Kombeve te Bashkueme ne fushen e problemeve ekonomike, Vishinski theksoi se institucjonet e Organizates se Kombeve te Bashkueme keshilli ekonomiko-socjal, komisjoni ekonomik per Europe dhe komisjoni ekonomik per Azi dhe Lindjen e larget jane terhjeke nga kryemja e detyreve me shum randesi, ndersa nga ana tjeter, te njajtat institucjone ekonomike t'Organizates se Kombeve te Bashkueme shofin si detyre kryesore qe ne çfardo menyre, te lehtesojne zhvillimin e „planit Marshall", i cili s'ka kurrfare lidhje me Organizaten e Kombeve te Bashkuem.

Tue theksue ne vazhdim te fjalimit te tij se punet e komisjonit per energjin atomike kane qene pa fryt per arsye se qeverija e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes ka kundershtue gjithmone qe t'arrihet vendimi mbi problemet themelore, te cilat qendrojne para ketij komisjonit, Vishinski ndermjet te tjerave tha:

„Bashkimi Sovjetik, sikurse asht e dijtun, thekson nevojen qe pa vonese te ndalohet perdorimi i armes atomike dhe qe te vendoset kontrolli i duhun nderkombetar per prumjen e ketij vendimi. Nevoja e ndalimit e armes atomike rrjedh nga vete karakteri i armes te ketij lloji, arme agresjoni e caktueme per mesymje, per shkaterrimin e qyteteve per zhdukjen masovike te banoreve paqesore.

Mbasi theksoi se propozimi amerikan shkon drejte per largimit e prumjes se nji vendimi per ndalimin e perdorimit t'energjis atomike per qellime ushtarake, Vishinski kaloi n'ana lizimin e politikes se jashtme te Shteteve te Bashkueme t'Amerikes.

„Mbas mbarimit te luftes se dyte botnore — tha Vishinski — shtetet e Bashkueme t'Amerikes e kane ndrrue politiken e tyne te jashtme. Qeverija e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes ka zavendesue luften politike kundra fuqive t'agresjonit me politiken ekspansjoniste dhe me [illegible] e qellimeve ne planet e saja te dominimit botnor".

Dhanja e perkrahjes se hapte vendeve te ndryshme e regjimeve dhe grupeve ma reakcjonare monarko-fashiste, dhe ndihma sistematike ketyne te fundit ne te holla dhe arme, organizimi i aleancave dhe blloqeve ushtarak, ndertimi i bazave te reja ajrore dhe detare, si dhe zgjanimi dhe ndertimi i bazave te krijueme gjate luftes kundra Gjermanis, Japonis dhe Italis simbas recetave ma moderne te teknikes ushtarake, propaganda e ashper per lufte te re kundra Bashkimit Sovjetik dhe te vendeve te demokracis popullore t'Europes lindore, nxitimi i madh n'armatim dhe kulti i vjedhjes i bombes atomike, e cila do te bahet melhem kundra te gjitha rrezigeve dhe te keqijave qe kercnojne boten kapitaliste, — qe se shka e karakterizon politiken e jashtme te Shteteve te Bashkueme t'Amerikes ne çastin e tashem.

Kjo politike asht politike e luftes, asht shpetim e brengos masat e gjana, te cilat jane per paqe dhe pune konstruktive paqesore. Kjo lloj politike nuk ka kurrgja te perbashket me politiken e paqes.

Sikurse asht e dijtun, qeverija e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes se bashku me qeverit e Britanis se Madhe dhe te Frances, ka organizue bllokun politik dhe ushtarak te pese vendeve, blok i cili nuk ka qellim qe te pengoje agresjonin gjerman dhe te forcoje ndihmen reciproke kundra nji agresjoni te tille. Kurrsesi ai nuk mund te vendoset nji qellim i tille, mbasi blloku ushtarak nuk asht i drejtuem kundra rrezikut te rimekembjes t'agresjonit gjerman Pakti parashef perfshimjen e pjeses perendimore te Gjermanis ne ket bllok, e cila gjithmone ka qene shtylla e militarizmit gjerman, dhe e cila para pak kohe ka sherbye si mbeshtetje e agresjonit hitlerjan. Vetvetiu kuptohet qe organizimi i aleancave te tilla asht ne kundershtim konkret me interesat dhe per perforcimin e paqes dhe te sigurimit te popujve.

Na dijme edhe per aleanca te tjera — aleanca ndermjet popujve paqedashes t'Europes, te cilet jane ba me qellim qe te pengojne perseritjen e agresjonit gjerman. Traktate te tilla jane ba ne mes te Bashkimit Sovjetik e te vendeve t'Europes Lindore dhe te Finlandis. Traktati Anglo-Sovjetik dhe Francezo-Sovjetik mbi ndihmen reciproke per 20 vjete jane ba ne te njajten baze. Marreveshtje dhe lidhje te tilla te bame n'ato traktatesh qellimi i te cilave asht pengimi i nji agresjoni te ri gjerman tanesisht perputhen me interesat e te gjithe popujve paqedashes dhe nuk mund te qojne ne nji grindje ndermjet vendeve paqedashese ose ne ndamjen e Europes. Mbi gjithe kete, traktate sikurse asht ky, i cili ka te baje me aleancen ushtarake te vendeve perendimore dhe te cilin e kane nenshkrue Britanija e Madhe, Franca, Belgjija, Holandija dhe Luksemburgu, lehte mundesi te drejtohen kundra vendeve, me te cilat kane qene aleat gjate luftes se dyte botnore. I gjithe shtypi britanik francez dhe amerikan haptazi shkruejne se aleanca ushtarake e pese vendeve perendimore drejtohet kundra Bashkimit Sovjetik dhe vendeve te demokracis se re. Traktat i tille nuk mund te merret kurrsesi si traktat qellimi i te cilit asht mbrojtja. Ata, te cilet nenshkruejne keso traktatesh dhe organizojne keso blloqesh kane politiken, e cila nuk ka asgja te perbashket me perforcimin e paqes dhe trimnojne luftenxitsat dhe organizatoret e luftes se re.

Rezolucjoni i pranuem ne vjetin e kalue ne seancen e dyte te Kuvendit te pergjithshem, e cila denon propagandimin e luftes se re dhe kerkon qe me ndihmen e shtypit dhe propagandes te ndihmojne perforcimin e marredhanjeve miqesore ndermjet vendeve, nuk i ka pengue nxitsat e luftes se re, te cilet jane ba edhe ma cinik gjate vjetit te kaluem dhe te cilet aktivitetet e tyne kriminal e kryejne me me shume cinizem tue u munduar qe te mbajne ne pelkuesen e luftes pjesen ma te madhe te njerzeve te thjeshte. Kjo propaganda asht percjelle me perloqjeta e rrenave dhe shpifjeve mbi agresjonin e Bashkimit Sovjetik dhe vendeve te demokracis se re. Tue dashte me paraqite Bashkimin Sovjetik si vend jodemokratik, e Shtetet e Bashkueme t'Amerikes, Britanin se Madhe dhe vendeve te tjera te bllokut Anglo-Sakson si vende demokratike. Te gjitha keto shoqnohen nga nji gare infernale n'armatim dhe perpunim te planit per sulmin kundra Bashkimit Sovjetik dhe vendeve te demokracis se re, si dhe pregatitjen e masave tjera ushtarake.

Ne lidhje me ket duhet me vue ne dukje qe edhe mbas tri vjetve nga mbarimi i luftes se dyte botnore endi egziston shtabi i perbashket Anglo-Amerikan, i cili mshefrazi zhvillon nji aktivitet kundra interesit te paqes. shtabi asht organizue ne vjetin 1942 ne kohen e luftes se Kombeve te Bashkuem kundra Gjermanis fashiste me qellim qe t'udheheq operacjonet ushtarake te aleateve. Ndermjet perfaqesuesve te shteteve te Bashkueme t'Amerikes ne ket shtab kryesor gjejme admiralin e flotes Lihija, admiralin Dentilt Njus, gjeneralin Beadli, e ne mes te perfaqesuesve te Britanis se Madhe admiralin Henri Mur, gjeneralin Viljam Morgan, dhe marshalin kryesor t'avijacjonit Hajderst. Ne shtatorin e vjetit 1947 n'Atlantikun verior nen udheheqjen e shtabit te perbashket Anglo-Amerikan, jane ba manevra, ne te cilat kane marre pjese fuqit detare te Britanis se Madhe, te Shteteve te Bashkueme t'Amerikes dhe te Kanadas. Ne shtatorin e vjetit 1948 jane ba manevra per t'ashtuquejtunen mbrojtje e Anglis, ne te cilat kane marre pjese fuqit ajrore ushtarake te Britanis se Madhe e te Shteteve te Bashkueme t'Amerikes. Ne te njajtjen kohe jane marre masat per zgjanimin e madh te bazave detare dhe ajrore dhe per efrytezimin e tyne n'aventurat e ardheshme te gjithllojshme. Ne shtyllat e shtypit, e veçanrisht ne shtypin e vendeve ne fjale diskutohet me nji ton t'eger nxites per lufte kundra Bashkimit Sovjetik dhe te vendeve te demokracis se re, mbi planet e ndryshem sulmues nga keto baza kundra Bashkimit Sovjetik, me qellim kou kret qe te frigesohen njerzit me nerva te dobta dhe qe te vehet ne dukje potencjali luftarak i Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, veçanerisht forca e fuqive „specjale ofensive", d.m.th. sikurse e precizon fletorja e perjavshme amerikane "Saterdej Ivning poste" ne numrin 11 te muejit shtatuer, bombarduesve te furnizuem me bomba atomike.

Ne kryeartikullin e botuem ne revisten e njoftun amerikane "Junajted pres end vorlot riport" te nande prillit te ketij vjeti, haptazi vertetohet qe po kryhet riorganizimi i fuqive ushtarake te Shteteve te Bashkueme t'Amerikes ne rast te ndermarrjeve luftarake n'Europe. Revista njikohesisht thekson qe Shtetet e Bashkueme t'Amerikes koncentrojne fuqit e tyne luftarake per rreth Bashkimit Sovjetik te cilat baza gjinden ne Britanin e Madhe. Revista permban hollesisht sulmet kryesore, te cilat i pregadite avjacjoni amerikan kundra Bashkimit Sovjetik, veçanerisht me ndihmen e gjuejtsave bombardjera me fuqi levizese rejeaktive, aeroplanat e furnizuem me bomba atomike. Ne ket revista asht botue edhe harta, e cila tregon drejtimet e sulmit t'armates aeronautike te Shteteve te Bashkueme simbas planit te nalipermendun. Ne skjarim te kesaj harte thuhet: "Shtetet e Bashkueme t'Amerikes sulmojne Rusin kryesisht me aeroplana. Krahinat e Mesdheut si dhe Britanija e Madhe e Lindja e Mesme do te kene randesi te pare. Krahinat polare do te kene ma pak randesi ne keto operacjone, ndersa Italija, Sicilija dhe Turqija do te bahen baza te randesishme. Bombat atomike do te perdoren per sulmin mbi Rusi me plote kapllesin e fjales".

Ne revisten tjeter amerikane „Nju Jorks magazin" te dates 10 mai, asht botue artikulli me te cilin shpallet kepandhja qe Shtetet e Bashkueme t'Amerikes nuk posedojne harta gjeografike te tavoleshme per njesen ma te madhe te territorese rusi „ per bombardimet qene nevojiten harta shum ma precize".

Ne kete artikull vehet ne dukje randesija e bazave luftarake ushtarake dhe ajrore, nga te cilat do te sulmohen qytetet sovjetike. Jane shenue gjithashtu distancat relative: „Distanca ne mes te Londres e te Moskes dhe anasjelltas asht 3.100 milja. Nga Tripoli deri ne Rostov 1.750 milja, nga Ferbanksi n'Alaske deri ne Vladivostok 3.400 milja, e prej bazes se Grenlandit e deri ne Sverdllovsk 3.300 milja . . ."

Shkrimi i pa perfillshem dis. i pa turp qe nxite lufte gjindet dhe ne harten qe e ka botue firma amerikane „Esho" ne Newjork. Kjo harte e cila flon per lufte, quhet harta e luftes se trete botnore per operacjonet luftarake ne Pacifik". Kjo harte asht nji shembull i propagandes se nxitjes per lufte kundra Bashkimit Sovjetik dhe vendeve demokratike t'Europes Lindore.

Mobilizimi i fuqive reakcjonare, te cilat e kane humbe besimin n'ardhmenin po vazhdohet pa nderpremje. Po fillohen pregatitje te ngutshme per opinjonin publik, po bahen shpifje te paturpshme dhe ma te tmerrshme kundra Bashkimit Sovjetik dhe vendeve te demokracis popullore. Po fillohet falsifikimi i fakteve ne menyre qe te mashtrohen miljona njerez te thjeshte dhe t'iu hiqet vrejtja e tyne prej nxitsave te vertete te luftes. Tue i botue me dhetra miljona fletore, revista, libra, plote meni t'eger ndaj demokracis dhe socjalizmit, tue ftue haptazi qe te sulmohen vendet liridashese qarqet reakcjonare te shteteve te Bashkueme t'Amerikes, te Britanis se Madhe dhe vendeve si jane Franca, Belgjija e tjera, nuk mjaftohen vetem me shpifje dhe fyeenje. Ne kete fushate marrin pjese jo vetem amateret, ne mes te ministrave te shquem, burrave te shtetit dhe senatoreve ne parlament, por edhe personalitete qe kane marre pozita te nalta zyrtare ne qeverinat e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, Britanis se Madhe, Frances dhe ne disa vende tjera, si per shembull ministri amerikan i mbrojtjes Fortstal, ministri i [illegible] i Sh. B. A. Rojal kryetari komisjonit te senatit Brikhez' antaret e parlamentit anglez Braun Harvej, Toma Mur, ndihmes shefi i fuqive aeronautike te shtabit kryesor t'Anglis me Moske Velsh, Marmilen dhe te tjere.

Keto gazeta nuk llomotisin ma me fjale, me parolla te pergjithshme, tue thirre ne lufte kundra Bashkimit Sovjetik dhe vendeve te demokracis popullore. Ata, e veçanrisht perfaqsuesit e permendun te komandes se nalte ushtarake te Shteteve te Bashkueme t'Amerikes propozojne perdorimin e aeroplanave ushtarak dhe bombes atomike per zhdukjen e Moskes, Leningradit, Kijevit, Harkovit dhe Odesës.

Kushtu, Forestal, ministri i mbrojtjes te Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, ne fjalimin e tij ne komisjonin e senatit per qeshtjen e fuqive t'aeronautikes ka insistue per zmadhimin e armates, tue kerkue kredit te posaçme prej 3 miljarda dollaresh per qellime ushtarake. Ai shpallte ne lufte kundra Bashkimit Sovjetik, tue thirre qe te krijohen forca te fuqi shume [illegible] luftarake, te cilat mund te jene ne gjendje qe te bajne gadishmeri te vazhdueshme, larg jashte teresit dhe bazave mu te cilat ka ditermue ne luften e fundit.

Ne te njajten kryme jane kryemue dhe fjalimet e Rojalit, Brigjesit, Braunit dhe munitorstave te tjere, te cilet haptazi kane thane qe te bahen gadtije t'industrin mugurore ne Batum dhe ne Baku, ne Basenin e Donecit dhe ne krahinat industrijale t'Uralit. Me gjithe deklaratat e shpeshta te kryetarit te qeveris se Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, Britanis se Madhe dhe te disa shteteve t'Europes Perendimore se si qeverit e tyne nuk kane kurrfare qellimesh agresive, n'ato vende ndihet nji nxitim i madh n'armatim.

Vendi i pare ne kete nxitim armatimi i perket Shteteve te Bashkueme t'Amerikes. Asht e njoftun se ne vjetin 1947, d. m. th. dy vjet mbas mbarimit te luftes botnore, armata amerikane ka qene tri here e zgjeruem ma e madhe se ne vjetin e paralufes. Shifet smadhim i vazhdueshem i fuqive aeronautike te Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, efektivi e te cilave ne vjetin 1947 kane arrijte 17 here ma teper se ne vjetin 1937. Ne te njajten kohe marina e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, e ka zmadhue per tri here e gjysem tonazhin e anijave ushtarake, e efektivin e flotes e ka zmadhue per pese here.

Buxheti i Shteteve te Bashkueme t'Amerikes per vjetin 1948—1949 dshmon qe shpenzimet per qellime ushtarake jane smadhue per afer 4 miljarde dollare ne krahasim me vjetin e kaluem.

Duhet me shtue — simbas vlerësimeve zyrtare — se asht parapa smadhimi per çdo vjet i buxhetit ushtarak, dedikue armatimit t'Armates aeronautike dhe fuqive detare te SH.B.A., per vjetin 1949—1950, 17 miljarde e 500 miljone dollare, per vjetin 1950—1951 20 miljarde dollare, per vjetin 1951—1952 21 miljarde e 500 miljone dollare dhe per vjetin 1952—1953 22 miljarde e 500 miljone dollare.

Vazhdohen shpenzimet kolosale per eksperimenta ushtarake dhe per prodhimin e te gjitha armeve te modeleve te reja, te cilat u sjellin prufite prej miljarda dollaresh kapitalistave dhe monopolistave te SH.B.A. SH.B.A. jo vetem qe vet po bajne pregaditje intensive per masa agresive kundra Bashkimit Sovjetik dhe vendeve te demokracis popullore, por edhe ndihmojne nji seri vendesh t'Europes Perendimore, qe ri pregatitin armatat e tyne me armet e veta e te gjitha keto i bajne nen pretekstin e forcimit te mbrojtjes, per pregatitjen e luftes vendeve ne rast te nji agresjoni. Ne shtyp jane duke bisedue mbi mundesin e perseritjes se ponusimeve t'armeve nga Sh. B. A. ne forme hueje dhe qiraje per disa vende t'Europes Perendimore.

Mandej Vishinski tha: „Simbas qendron situata ne fushen e marredhanjeve nderkombetare ne çastin e tashem. Keto jane kushtet e politikes se jashtme ma te cilat fillon punen sesioni i trete e Kuvendit te pergjithshem te OKB. Pa kurrfare mundesi mund te parashihet, [illegible] ka qene edhe ne sesionin e perparshem dhe sikurse ka qene edhe ne komitetet dhe komisjonet e [illegible] t'OKB, se do te mbizotnoj [illegible] [illegible] dhe te nagfunikat mbi bashkepunimin nderkombetar, paqes dhe sigurimin e popujve, mbi [illegible] e njerit mbi demokracin. Po, na dijme ne te njajten kohe se kjo [illegible] i rrembyeshem i cili nuk ka asgja te perbashket me interesat e paqes dhe mbrojtjen e vendeve te tjera, po drejtohet mbas shtabit t'OKB ne shtabe kryesore te mbrojtjes dhe grupit ushtarak te Sh. B. A., Britanis se madhe dhe te disa vendeve tjera te cilat gjinden ne sferen e influences Anglo-Amerikane.

Nji [illegible] e tille nuk mund te lejohet. Miljona njerzish te thjeshte, te cilet i kane paguar me gjak krimet e fashizmit hitlerjan dhe organizatoreve te luftes se dyte botnore e cila pruni mjerime, nuk mund te lejojne luften e re, e cila do ti sjelle mbi njerzimin shkatrrime te tmerrshme dhe vuejtje".

Botimi i Keshillit Krahinuer te Frontit popullor—Siparmarrja per shtyp dhe botime "Miljadin Popoviq„ Prishtine.
Pajtimet ne fletarem i pranon: Administrata dhe ekspedicioni. Numri i çekut 906030.